



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2558/3 Prot.,

Datë 31.10.2023

V E N D I M
Nr. 1106 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2023 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-83663-10-13-2023, me objekt “Blerje Kancelari për vitin 2023”, me fond limit: 2.450.881 lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ankimues: Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK,
me NIPT: K21605003M, dhe Adresë:
Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
Adresa:Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-83663-10-13-2023, me objekt “Blerje Kancelari për vitin 2023”, me fond limit: 2.450.881 lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/3515 datë 19.10.2023 dhe me nr. 2558/2023 prot., datë 19.10.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të

dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4 Njëpërmjet shkresës nr. 2236/13 prot., datë 24.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2558/2 prot., datë 30.10.2023 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik

“Informacion” i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e paraqitur.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka përcjellë vendimin me Nr.18, datë 23.10.2023 dhe Nr 2236/12 prot., protokolluar me tonën me nr.2558/2, datë 30.10.2023, KSHA ka vendosur pranimin e plotë të ankesës në lidhje me ndryshime në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Interlogistic” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1.Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK me numër ankimi elektronik A/2023/3515 datë 19.10.2023 dhe me nr. 2558/2023 prot., datë 19.10.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

[...Ankimesi kundërshton: Në shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar afati i lëvrimit nga ana Juaj si më poshtë: Afatet e lëvrimit: • Të gjithë artikujt do të sillen brënda 10 ditëve pas lidhjes së kontratës në magazinën e Fondit (me përjashtim të artikullit letër A4) ku do të merren në dorëzim nga një komision i ngritur për marrjen në dorëzim të këtyre artikujve. • Artikulli letër A4 do të lëvrohet pjesë-pjesë sipas nevojave të Fondit, një ditë pas marrjes së njoftimit nga AK. • Mallrat do të sillen pranë Fondit me mjetet e kontraktuesit. Transporti i mallrave, përfshirë ngarkim - shkarkimin në magazinën e Fondit do të realizohet me mjetet dhe personelin e kontraktuesit Në lidhje me sa është kërkuar nga ana e juaj, pretendojmë se ky afat është tepër i shkurtër, kjo pasi bëhet fjalë për furnizimin me sasi të konsiderueshme të artikujve të cilët importohen nga furnitorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Duke qënë se operatorët ekonomik për artikujt objekt i kësaj procedure prokurimi duhet të marrin furnizimin nga furnitorë të huaj dhe duke marrë në konsideratë kushtet aktuale të shkaktuara globale të shkaktuara nga Pandemia Covid-19 si dhe lufta në Ukrainë, kaosi i shkaktuar lidhur me transportin dhe rritja shumë e madhe e çmimeve të tij, e bëjnë shumë të vështirë që malli të merret nga jashtë shtetit

dhe të lëvrohet në adresën tuaj brenda afatit të përcaktuar në DST. Të ndodhur në kushtet e krizës botërore për sa i përket transportit dhe lëvrimin të mallrave, kërkojmë që afati i lëvrimin të jetë minimalisht 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës....]

III.1.2. Nëpërmjet shkresës nr. 2236/13 prot., datë 24.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2558/2 prot., datë 30.10.2023 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e paraqitur.

III.1.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka përcjellë vendimin me Nr.18, datë 23.10.2023 dhe Nr 2236/12 prot., të KSHA-së “Mbi shqyrtimin e kërkesës ankimore të datës 19.10.2023 nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, dhe ka vendosur pranimin e plotë të saj në lidhje me ndryshime në dokumentet e tenderit më arsyetimin: “Pas shqyrtimit të DST, KSHA mbështetur në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se: Afati 10 ditor për lëvrimin e mallrave për procedurën e prokurimit “Blerje Kancelari për vitin 2023” është një afat tepër i shkurtër për realizimin e kontratës dhe mund të sjellë problematika për të gjitha operatorët ekonomikë. Duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme dhe AK nuk ka emergjenca për lëvrimin e këtyre mallrave, afati 30 ditor për lëvrimin e mallit është i arsyeshëm.

Për këto arsye, bazuar në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, KSHA e ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

Vendosi.

- 1. Pranimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK.*
- 2. Ky vendim i njoftohet menjëherë ankimesit dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.2. Referuar Nenit 30 i LPP-së parashikon se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.2.1. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

- a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*
 - i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;*

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.3. Sa më sipër, referuar ankesës, informacionit të autotritetiti kontraktor dorëzuar pranë KPP-së, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-83663-10-13-2023, me objekt “Blerje Kancelari për vitin 2023”, me fond limit: 2.450.881 lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
2. Autoriteti kontraktor, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

